



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:251059
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06183112

ARJ.nr.122/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Nenad Lazić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Komuna e Podujevës, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe me palën e interesit F.Q., nga fshati Sh., Komuna e P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatos Zeqiri, avokat nga Prishtina, me bazë juridike anulim i aktit - vendimit administrativ të të paditurës Nr.A-144/21 të datës 04.10.2021, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të palës së interesuar, ushtruar nga i autorizuari i tij, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.412/2023, të datës 04.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18 shtator 2024, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga pala e interesuar F.Q., nga fshati Sh., Komuna e P., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë AA.nr.412/2023, të datës 04.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.412/2023, të datës 04.06.2024, **Refuzohet** si e pabazuar ankesa e palës së interesit F.Q., e datës 11.05.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2664/2021, i datës 12.04.2023, **vërtetohet**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, pala e interesuar, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes së të drejtës materiale, me propozim që të: **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.412/2023, të datës 04.06.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2664/2021, të datës 12.04.2023, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, sipas pretendimeve nga kërkesa dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës, gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pa bazuar.

Nga provat në shkresat e lëndës rezulton se, paditësja Komuna e Podujevës - Drejtoria e Inspeksionit, me vendimin nr.390/20 dhe nr. prot. 11-354/03-0070884/21 të datës 19.08.2021 ka vendosur si në vijim: I. Urdhërohet F.Q., i lindur më 15.01.1967 në fshatin Sh., me vendbanim të përhershëm në fshatin Sh., me nr. Personal, që në një afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të këtij vendimi të bëjë rrënimin (largimin) e ndërtimit pa leje të objektit Afarist P-O të ndërtuar në Sh., Rr. "Magjistrale PD-PR", ana e majtë në Sh, në parcelën kadastrale nr.....-, dhe- ZK Sh., dhe të bëjë kthimin e hapësirës në gjendjen e mëparshme ekzistuese para ndërtimit. II. Rrënimi i objektit bëhet për shkak se nuk posedon leje ndërtimore nga organi kompetent i Komunës. Investitori mund të zbatojë urdhrin për rrënim vullnetarisht, në mënyrë dhe përmes mjeteve që ai i përcakton dhe të cilat janë të sigurta për ndërtesat përreth popullsinë dhe mjedisin. III. Në rast të moszbatimit të urdhrin nga pika I organi kompetent do të bëjë rrënimin e ndërtimit pa leje të objektit afarist P+O dhe kostoja e rrënitit do të mbulohet nga pronari, kontraktori ose pala tjetër përgjegjëse për ndërtimin. IV. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e Aktvendimit. Ndërsa me Vendimin nr.11-354/01-0073020/21 të Komisionit të Shqyrtimit të ankesave - Komuna e Podujevës, refuzohet ankesa e palës ankuese, këtu palës së interesuar, parashtruar kundër vendimit për rrënimin e ndërtimit pa leje nr.390/20 dhe nr.prot. 11-354/03-0070884/21.

Kundër këtij vendimi pala e interesuar ka parashtruar ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me vendimin e kontestuar Nr.A-144/21 të datës 04.10.2021, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është vendosur si në vijim: I. PEZULLOHET procedura e vendosjes në çështjen administrative sipas ankesës së ushtruar nga F.Q., fshati Sh., Komuna e Podujevës, kundër Vendimit Nr.390/20 datë 13.08.2021 të Drejtorisë së Inspeksionit-Inspeksioni i Ndërtimit, Komuna e Podujevës dhe Vendimit Nr.11-354/01-0073020/21 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Komunës së Podujevës, për rrënimin e objektit për afarizëm .+., të ndërtuar në Sh., Komuna e P., Rr. Magjistrale PD-Pr, ana e majtë në Sh., në parcelat kadastrale Nr.....-., dhe Nr.....-., ZK Sh., dhe Vendimi Nr.11-354/01-007302/21, të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, Komuna e Podujevës. Në pikën II. Pezullimi i çështjes administrative nga pika I e këtij Vendimi do të zgjasë deri në eliminimin e shkaqeve dhe rrethanave të cilat kanë ndikuar në pezullim sipas këtij vendimi.

Në arsyetim të këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: Organi i shkallës së dytë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, konstatoi se lidhur me këtë çështje administrativo-juridike, është iniciuar padia nr.shkr.1 të datës 23.09.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, andaj pezullohet kjo çështje administrativo-juridike deri në vendimin përfundimtar nga gjykata dhe e njëjta nuk mund të vazhdohet deri në një vendim nga gjykata, konform dispozitave të nenit 85 paragraf 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kundër këtij vendimi pala paditëse ka iniciuar konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr.2664/2021, të datës 12.04.2023, ka vendosur si në vijim: APROVOHET kërkesëpafia e paditëses Komuna e Podujevës si e bazuar. Në pikën II. ANULOHET Vendimi Nr.A-144/21 i

datës 04.10.2021 dhe DETYROHET e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh me vendim të vendos në lidhje me kërkesën e palës paditëse dhe të njëjtin t'ia dorëzoj palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Në pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Në arsyetimin e aktgjykimit të saj gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera arsyeton se: Gjykata gjeti se me rastin e marrjes së këtij vendimi, e paditura i është referuar nenit 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili e trajton pezullimin e procedurës në rastet kur ka çështje paraprake. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se në rastin konkret, inicimi i procedurës gjyqësore, qoftë nga palët ndërgjyqëse apo kushdo tjetër që mund të ndërlidhet me rastin konkret, nuk mund të qëndroj si arsye për organin e paditur, që pa ndonjë arsyetim të detajuar mirë dhe mbi bazë të ligjit, të pezulloj procedurën administrative, e cila duhet të zhvillohet në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në LPPA. Në ri procedurë e mbi bazën e nenit 132 të LPPA-së, organi i paditur obligohet të rishqyrtoj kërkesën e paditëses, të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, duke shqyrtuar ankesën e ankuesit, përkatësisht palës së interesit në këtë konflikt administrativ, ashtu që të marr në shqyrtim të gjitha provat e prezantuara nga pala paditëse e veçanërisht zbatimin e plotë të parimit të pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme si dhe parimin e administratës së hapur, të përcaktuar në nenin 7, respektivisht nenin 8 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Tutje theksohet se: Gjykata hodhi poshtë pretendimet e të paditurës të dhëna si në përgjigje në padi, për faktin që Gjykatës as me përgjigje në padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ju ofrua asnjë provë mbi bazën e së cilës do të mund të bazohen pretendimet e të paditurës. Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar, ndërsa në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë. Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë, në kuptim të nenit 5 lidhur me nenin 44.2, dhe 46 par.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata e shkallës së parë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së interesuar në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe nenit 194 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses dhe ka anuluar vendimin kontestues duke u bazuar në dispozitat e LKA-së, LPPA-së, dhe LPK-së dhe ka detyruar të paditurën që në afat prej 30 ditësh të vendos lidhur me kërkesën e palës paditëse, sepse i njëjti nuk është nxjerrë sipas formës dhe përmbajtjes ashtu si parashihet me nenin 47 dhe 48 të LPPA, andaj si i tillë përmban të meta esenciale për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij si në kuptim të nenit 9 dhe 44 të LKA. Në këtë çështje organi i paditur është dashur që të vendos sipas ankesës së palës ankuese, (tani palë e interesuar në procedurë gjyqësore), në mënyrë meritore sipas ankesës së tij

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë theksohet se: Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase ankuesi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar

saktësisht se ku qëndrojnë shkeljet e dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPK-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Tutje theksohet se: Njëjtë si gjykata e shkallës së parë edhe kolegji, vlerëson se Vendimi i të paditurit, nuk është nxjerrë sipas formës dhe përmbajtjes si parashihet, me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të LPPA. I njëjti duhet të rishqyrtojë kërkesën e ankuesit-paditësit, të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, ti shqyrtojë të gjitha provat e prezantuara nga pala, ashtu siç është obliguar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Mbi këtë gjendje të fakteve Gjykata e Apelit, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe ligjor dhe për shkak të metave të cekura si më lartë është anuluar Vendimi i të paditurit, dhe e paditura është obliguar, që në ri procedurë të veprojnë si në vështrim të nenit 65 të LKA-së, që pas administrimit të provave të nevojshme duke ju përmbajtur edhe vërejtjeve dhe sugjerimeve të gjykatës, të vendos në këtë çështje juridike me vendim përmbajtësor, ashtu si parashihet me dispozitat e LPPA-së, dhe ligjit material në fuqi. Andaj, pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi si i tillë nuk vihet në pyetje, ankesa e palës së interesuar refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si i drejtë dhe ligjor.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pas shqyrtimit të kërkesës së palës së interesuar për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të provave tjera në shkresat e lëndës, gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë, me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses nga gjykata e shkallës së parë, refuzimin e ankesës dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e shkallës së dytë të kontestuar me kërkesë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, si të drejtë dhe ligjor në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, ngase aktgjykimi i Gjykatës së Apelit si dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk janë të përfshirë me aplikimin e gabuar të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala e interesuar në kërkesën e tij.

Kolegji i kësaj gjykate, njëjtë si gjykatat e instancave më të ulëta, vlerëson se akti administrativ i të paditurës përmban të meta esenciale që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së tij, kjo për faktin se akti administrativ i mungon arsytimi ligjor përkatësisht arsytimi i këtij akti nuk është i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk përmban elementet e përcaktuara si parashihet në nenin 48 paragraf 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Po ashtu arsytimi i tij nuk gjen as mbështetje në dispozitën ligjore të cilës i referohet e paditura, përkatësisht nenit 85 paragraf 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga çka edhe rezulton se të njëjtit i mungon baza ligjore dhe arsytimi, andaj me të drejtë është anuluar.

Gjykata Supreme pretendimet e palës së interesuar si në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 të LKA-së, përkatësisht lidhur me parimin e deklarimit dhe të qasjes në shkresat e lëndës, ngase nga se gjykata e shkallës së parë përkundër faktit se në këtë çështje të konfliktit administrativ ka caktuar seancë gjyqësore, palës së interesuar pos thirrjes nuk i ka dërguar padinë dhe dokumentet e bashkangjitura asaj, në mënyrë që i njëjti të ketë mundësinë që brenda afatit të përcaktuar ligjor të jap përgjigje në padi, veprim ky procedural të cilin gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim ta bëjë konform nenit 37 paragraf 1 të LKA-së, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime i shqyrtoi me kujdes dhe ndonëse të njëjtat janë

pjesërisht të qëndrueshme, megjithatë i refuzon si jo me ndikim për të vendosur në mënyrë tjetër në këtë çështje, ngase nga procesverbali i datës 12.04.2023, ka rezultuar se i autorizuar i palës së interesuar përgjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, nëse paditësi ka kërkuar anulimin e aktit administrativ rrjedhimisht vendimit të Ministrisë, atëherë çështja duhet të kthehet pranë të paditurës në mënyrë që e njëjta të vendosë meritore sipas ankesës së palës të cilin e përfaqëson, palën me interes, ndërsa në fjalën përfundimtare gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj si të parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor. Kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se, mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me kërkesën e palës së interesuar dhe nuk provohet se është në dëm të tij sepse me të drejtë është anuluar vendimi i të paditurës i MMPH dhe çështja i është kthyer në rivendosje për të vendosur në mënyrë meritore pikërisht sipas ankesës së tij të paraqitur në këtë organ, prandaj nga kjo gjendje rezulton se me të drejtë është refuzuar ankesa e tij nga Gjykata e Apelit me që nuk ka elemente për tu vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse edhe sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme, akti administrativ i të paditurës përmban të meta esenciale që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Gjykata e shkallës së parë është dashur që për nulitetin e aktit të kontestuar të kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe të njëjtin ta anuloj pa e dërguar fare për përgjigje në padi ashtu siç është përcaktuar në nenin 35 të LKA-së, përkatësisht edhe pa caktuar fare seancë gjyqësore, andaj pretendimet e palës së interesuar në kërkesë në këtë drejtim refuzohen si jo të qëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për deri sa kthimi në rivendosje tek e paditura nga gjykata nuk është në dëm të palës së interesuar, por as të palës paditëse, përkundrazi detyrohet e paditura që të vendos në mënyrë meritore, duke nxjerrë vendim të drejtë dhe përmbajtjesor si parashihet me dispozita të LPPA dhe ligjit material.

Pretendimet si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me afatshmërinë e padisë, kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të bazuara dhe të qëndrueshme, andaj kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore në bazë të provave në shkresë të lëndës. Nga shkresat e lëndës shihet se paditësja me përgjigje në ankesë të datës 25.05.2023, ka dorëzuar provën: Shkresën me nr. 3536-21 dhe Rekomandë R 1858300 si dhe protokollin e pranimit, ku shihet se paditësja vendimin e të paditurës e ka pranuar me datë 12.10.2021, ndërsa padinë e ka parashtruar më datë 09.11.2021, brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga çka ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur në baza ligjore me vendosjen e çështjes si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga theksimet si më lartë, dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative u vendos si së dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.122/2024, datë 18 shtator 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani